



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**

**PËR REZULTATIN E SHORTIT PËR CAKTIMIN E RELATORIT TË KËRKESËS ANKIMORE  
NR. 01, PARAQITUR NË KQZ NË DATËN 21.05.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 21.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Caktimin e Anëtarit të KQZ-së që do të verifikojë dhe relatojë kërkesën ankimore nr.01 të paraqitur më datë 21.05.2019.

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a" dhe neni 129, pika 1 të ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

**V Ë R E N:**

Në mbledhjen e datës 21.05.2019, ora 19:00, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 129, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Vendimin e KQZ-së nr. 21, datë 29.01.2013 "Për miratimin e rregullave për hedhjen e shortit për caktimin e anëtarëve të KQZ-së që relatojnë kërkesat ankimore të regjistruara në KQZ", procedoi me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore me nr. 01 regjistri, të paraqitur në KQZ në datë 21.05.2019.



## **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, dhe nenin 129 pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

## **V E N D O S I:**

1. Kërkesa ankimore e depozituar dhe e regjistruar me nr. 01, regj, datë 21.05.2019 në regjistrin e ankimeve zgjedhore në KQZ, do të raportohet nga z. Denar Biba.
2. Relatimi do të bëhet në datën 21.05.2019, në orën 19:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 615 i Vendimit      Data 21.05.2019      Ora 19:00 e Vendimit**

Për rezultatin e shortit për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 01,  
të paraqitur në KQZ në datën 21.05.2019